

URDHËR
Nr.219, datë 1.4.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 147, DATË 9.3.2020, “PËR
NDERPRERJEN E NDËRHYRJEVE KIRURGJIKALE TË PLANIFIKUARA NË
QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA” DHE SPITALIN
UNIVERSITAR “SHEFQET NDROQI”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit 10107 datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 9106 datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, vendimit të datës 8.3.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri”, si dhe udhëzimit nr. 395 datë 8.3.2020 të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

Në pikën 1, të urdhrin nr. 147, datë 9.3.2020, “Për ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjike të planifikuara në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, togfjalëshi “deri në datën 3 prill 2020”, zëvendësohet me togfjalëshin “deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**